



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

SEKRETARI I ZYRËS - SECRETARY OFFICE - SEKRETAR KANCELARIJE

Nr. 08 / 2022

Data: 18.02.2022

Sekretari i Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 18 të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), si dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrative (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë (26.08.2021), si dhe Rregulloren (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (21 qershor 2017), nxjerr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE/PROGRAMEVE PËR PERSONA FIZIK DHE OJQ

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve/programeve për persona fizik dhe Organizata jo Qeveritare (OJQ).
2. Për implementimin e thirrjes publike nga pika 1 e këtij Vendimi do të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrative (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë, si dhe Rregullores (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare nga thirrja publike për projektet /programet e personave fizik dhe OJQ-ve, do të bëhet nga buxheti i Zyrës së Presidentes, kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Shuma e përgjithshme e ndarë për këtë thirrje publike është 120,000 €.
4. Mjetet financiare nga pika 3 e këtij Vendimi do të ndahen në pajtim me thirrjen publike për financimin e projekteve/programeve të personave fizik dhe OJQ-ve, vlerësimin e aplikacioneve dhe dokumentacionit përkatës për implementimin e thirrjes publike.
5. Thirrja publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve/programeve për persona fizik dhe OJQ, si dhe dokumentacioni përkatës për aplikim publikohen në ueb-faqen e Presidentes së Republikës së Kosovës.

6. Thirrja publike do të Implementohet nga Komisioni përkatës dhe trupat tjerë që do t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësit në pajtim me Udhëzimin Administrative (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë, si dhe Rregulloren (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

7. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Fehmi MEHMETI
U.d. Sekretar i Zyrës së Presidentes

Vendimi t'i dërgohet:

1. Zyrës së Sekretarit;
2. Departamentit të Administratës dhe Buxhetit;
3. Komisionit të Vlerësimit për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në Presidencë.
4. a/a.



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNICE

SEKRETARI I ZYRËS – SECRETARY OFFICE – SEKRETAR KANCELARIJE

Br. 08/2022

Datum: 18.02.2022. godine

Sekretar Kancelarije predsednice Republike Kosovo,

U skladu sa članom 17 Zakona Br. 03/L-094 o predsedniku Republike Kosovo (Službeni list br. 47, od 25. januara 2009. godine), člana 18 Uredbe (P) Br. 02/2016 o organizacionoj strukturi Predsedništva (08.09.2016. godine), kao i na osnovu Administrativnog uputstva (SKP) Br. 04/2021 o dodeli subvencija u Predsedništvu (26.08.2021. godine) i Uredbe (MF) Br. 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO (21. jun 2017. godine), donosi:

ODLUKU

**O OBJAVLJIVANJU JAVNOG POZIVA ZA PRUŽANJE FINANSIJSKE PODRŠKE ZA
FINANSIRANJE PROJEKATA/PROGRAMA ZA FIZIČKA LICA I NVO**

1. Ovlašćuje se objavljivanje javnog poziva za pružanje finansijske podrške za finansiranje projekata/programa za fizička lica i za nevladine organizacije (NVO).
2. Radi sprovođenja javnog poziva iz tačke 1 ove odluke, sprovedeće se odredbe Administrativnog uputstva (SKP) Br. 04/2021 o dodeli subvencija u Predsedništvu, kao i Uredbe (MF) Br. 04/2017 od kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO.
3. Finansijska podrška iz javnog poziva za projekte/programme fizičkih lica i NVO izvršiće se iz budžeta Kancelarije predsednice, kategorija subvencija i transfera. Ukupno dodeljeni iznos za ovaj javni poziv je 120,000€.
4. Finansijska sredstva iz tačke 3 ove odluke će se dodeliti u skladu sa javnim pozivom za finansiranje projekata/programa fizičkih lica i NVO-a, ocenom prijava i dotične dokumentacije za sprovođenje javnog poziva.
5. Javni poziv za pružanje finansijske pomoći za finansiranje projekata/programa za fizička lica i NVO, kao i dotična dokumentacija za prijavljivanje se objavljuju na internet stranici Kancelarije predsednice Republike Kosovo.

6. Javni poziv će sprovesti dotična Komisija i druga tela, koja će vršiti dužnosti i odgovornosti u skladu sa Administrativnim uputstvom (SKP) br. 04/2021 o dodeli subvencija u Predsedništvu, kao i sa Uredbom (MF) Br. 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO.

7. Odluka stupa na snagu na dan potpisivanja.

Fehmi MEHMETI

v.d. sekretara Kancelarije predsednice

Odluku poslati:

- 1. Kancelariji sekretara;*
- 2. Odeljenju administracije i budžeta;*
- 3. Komisiji za ocenu dodele finansijskih sredstava iz kategorije subvencija u Predsedništvu.*
- 4. a/a.*